



STRATEGJIA E AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE

2023-2027

PËRMBAJTJA

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	5
II. AMF – RREGULLATORI I TREGJEVE FINANCIARE JOBANKARE	6
III. SFIDAT E AUTORITETIT PËRBALLË ZHVILLIMEVE TË SHPEJTA NË TREGJET FINANCIARE	7
IV. PRIORITETET STRATEGJIKE DHE NDËRSEKTORIALE	8
PRIORITETET STRATEGJIKE	9
1. FORCIMI I STABILITETIT FINANCIAR, RITJA E EFEKTIVITETIT TË MBIKËQYRJES DHE INTEGRITETI I TREGJEVE	9
1.1 Ruajtja dhe forcimi i stabilitetit financiar	9
1.2 Rritja e efektivitetit të veprimtarisë mbikëqyrëse të tregjeve	10
1.2.1 Forcimi i proceseve mbikëqyrëse drejt standardeve më të mira ndërkombëtare	10
1.2.2 Implementimi i udhërrëfyesit drejt regjimit Solvency II, në tregun e sigurimeve	11
1.3 Integriteti i tregjeve	12
1.3.1 Rritja e transparencës	12
1.3.2 Monitorimi i abuzimit me tregun	13
1.3.3 Forcimi i kontroleve dhe qeverisjes korporative	13
1.3.4 Parandalimi i pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit	14
2. PËRAFRIMI I LEGJISLACIONIT ME STANDARDET EVROPIANE, ZHVILLIMI DHE MODERNIZIMI I TREGJEVE	15
2.1 Përafrimi i legjislacionit me Direktivat Evropiane	15
2.2 Mbështetja e zhvillimit dhe modernizimit të tregjeve	16
3. MBROJTJA E INTERESAVE TË KONSUMATORËVE DHE INVESTITORËVE, RITJA E PËRFSHIRJES FINANCIARE DHE EDUKIMI FINANCIAR	19
3.1 Mbrojtja e interesave të konsumatorëve dhe investitorëve	19
3.1.1 Monitorimi i sjelljes së operatorëve të tregut	19
3.1.2 Modernizimi i sistemeve për trajtimin e ankesave	20
3.1.3 Skemat mbrojtëse të kompensimit	20
3.2 Rritja e përfshirjes financiare në tregjet nën mbikëqyrje	21
3.3 Rritja e edukimit financiar dhe trajnimi i profesionistëve	22
PRIORITETET NDËRSEKTORIALE	23
4. FINANCIMI I GJELBËR	23
4.1 Integrimi i parimeve të qëndrueshmërisë dhe përfshirja e faktorëve ESG në bazën rregullatore	23
4.2 Promovimi i emetimit të Obligacioneve të Gjelbra	24
4.3 Koordinim ndërinstytucional për nxitjen e financave të gjelbra	25
5. DIGJITALIZIMI DHE SISTEMET E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT	26
5.1 Përmirësimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit	26
5.2 Rritja e sigurisë kibernetike	26

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Strategjia e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF) për periudhën 2023-2027 përfaqëson dokumentin themelor të institucionit, që kombinon agjendën e integritetit në Bashkimin Evropian me objektivat për zhvillimin dhe mirërregullimin e tregjeve nën mbikëqyrje. Ky dokument hartohet në vijim të dokumentit strategjik të AMF-së 2018-2022 dhe paraqet vizionin e Autoritetit për zhvillime të qëndrueshme dhe të sigurta në tregjet nën mbikëqyrje.

Objektivat e këtij dokumenti strategjik institucional ndërveprojnë me objektivat e përcaktuara në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022-2030, e cila ndër të tjera përfshin edhe politikën kombëtare për zhvillimin e sektorit financiar jobankar, nëpërmjet zgjerimit të tregjeve të kapitalit, të tregut të sigurimeve, tregut të pensioneve private vullnetare, si dhe zhvillimit të financimit të gjelbër dhe harmonizimit me praktikën evropiane në financat e gjelbra.

Kjo strategji është konceptuar duke marrë në konsideratë madhësinë dhe nivelin e zhvillimit të tregut financiar jobankar në Shqipëri, si edhe pëmbushjen e angazhimeve të Shqipërisë në procesin e integritetit evropian.

Strategjia 5-vjeçare 2023-2027, përcakton disa prioritete të rëndësishme për zhvillim, për periudhën afatmesme dhe është strukturuar sipas drejtimeve të mëposhtme:

- Forcimi i stabilitetit financiar, rritja e efektivitetit të mbikëqyrjes dhe integritetit të tregjeve;
- Përafrimi i legjislacionit me standardet evropiane zhvillimi dhe modernizimi i tregjeve;
- Mbrojtja e interesave të konsumatorit dhe investitorit;
- Zhvillimi i financimit të gjelbër dhe harmonizimi me praktikën evropiane;
- Digjitalizimi dhe përmirësimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit.

Integriteti, besimi, profesionalizmi dhe angazhimi, janë vlerat që kanë udhëhequr AMF-në që nga krijimi i saj dhe përbëjnë themelin e drejtimit institucional dhe pikat kryesore të referimit.

Në periudhën 2023 – 2027, AMF do të përqendrohet në optimizimin dhe rritjen e efektivitetit të mbikëqyrjes, nëpërmjet përafrimit të legjislacionit me standardet dhe praktikën më të mira evropiane. Në funksion të mbrojtjes së konsumatorëve dhe investitorëve, Autoriteti do të avancojë standardet rregullatore, duke rritur kërkesat për transparencë dhe informacion. Zhvillimi i financimit të gjelbër dhe harmonizimi me praktikën evropiane në financat e gjelbra vlerësohen thelbësore për një ekonomi dhe sistem financiar të qëndrueshëm, në kuadër të nismës *European Green Deal* dhe angazhimeve të ndërmarra nga Shqipëria përmes nënshkrimit të marrëveshjes së Parisit, apo agjendës 2030 të Kombeve të Bashkuara për një zhvillim të qëndrueshëm. Në mbështetje të kësaj strategjie, do të vlerësohen mundësitë, kapacitetet, infrastruktura dhe sistemet e teknologjisë së informacionit.

Zbatimi i strategjisë do të realizohet hap pas hapi, duke u fokusuar në prioritetet strategjike dhe ato ndërsektoriale. Objektivat që AMF komunikon në vazhdimësi janë të natyrës afatmesme, me plan veprimi të orientuar drejt prioriteteve vjetore, të cilat mund të rishikohen në varësi të dinamikës së zhvillimit institucional dhe të tregjeve. Ky dokument strategjik do të mbështetet nga plane të detajuara vjetore me objektiva të qarta, që do të ndihmojnë zbatimin e strategjisë.

II. AMF – RREGULLATORI I TREGJEVE FINANCIARE JOBANKARE

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare është krijuar në bazë të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, si institucion juridik publik, i pavarur në ushtrimin e kompetencave të tij, që raporton në Kuvendin e Shqipërisë. Ai licencon, rregullon dhe mbikëqyr aktivitetin e tregut të kapitaleve, tregut të sigurimeve, tregut të fondeve të pensioneve vullnetare dhe operatorëve të tyre, si dhe veprimtari të tjera financiare jobankare.

MISIONI

Misioni themelor i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare është të kontribuojë në nxitjen e qëndrueshmërisë, të sigurojë funksionimin efektiv të tregjeve financiare jobankare, rritjen e transparencës dhe besueshmërisë në tregjet financiare nën mbikëqyrje dhe respektimin e ligjit. Përmbushjen e misionit të tij, Autoriteti e ushtron me anë të funksionit rregullativ dhe mbikëqyrës.

VIZIONI

Autoriteti synon promovimin dhe nxitjen e standardeve të larta për mbrojtjen e konsumatorëve dhe integritetin e të licencuarve, garantimin e stabilitetit të tregut financiar jobankar, si dhe përmirësimin e shkallës së profesionalizmit, nëpërmjet forcimit të vazhdueshëm të rregullimit dhe mbikëqyrjes të tregjeve. Vizioni i Autoritetit është të kontribuojë drejt për afrimit legjislativ dhe rregullator me Bashkimin Evropian, për forcimin e standardeve të tregjeve nën mbikëqyrje, si dhe të lehtësojë ndërlidhjen e tregjeve vendase me ato ndërkombëtare.

III. SFIDAT E AUTORITETIT PËRBALLË ZHVILLIMEVE TË SHPEJTA NË TREGJET FINANCIARE

Tregjet financiare nën mbikëqyrjen e Autoritetit, gjatë viteve të fundit rezultuan të qëndrueshme dhe me ecuri pozitive, duke i rezistuar efekteve vazhduese të pandemisë Covid-19, ngjarjeve të tërmetit të vitit 2019 dhe zhvillimeve gjeopolitike gjatë vitit 2022. Autoriteti ka monitoruar me kujdes zhvillimet në tregje dhe ka vlerësuar në vijimësi ndikimin e këtyre situatave në treguesit financiarë të subjekteve nën mbikëqyrje.

Mësimet e nxjerra nga krizat financiare ndër vite kanë bërë që t'i kushtohet vëmendje procesit rregullues e mbikëqyrës të sektorit financiar, duke u përqendruar jo vetëm në mbarëvajtjen e institucioneve financiare të marra veçmas, por edhe në nxitjen e qëndrueshmërisë financiare të tregjeve në tërësi, rritjen e bashkërendimit të veprimeve të autoriteteve rregullatore në vend dhe përtej kufijve, duke forcuar standardet mbikëqyrëse e rregullatore sipas praktikave më të mira ndërkombëtare.

Kapërcimi i sfidave me të cilat përballen tregjet nën mbikëqyrjen e AMF diktojnë përcaktimin e disa drejtimeve të rëndësishme për zhvillim në periudhën afatmesme (2023-2027), si dhe identifikimin e veprimeve, në drejtim të nxitjes së qëndrueshmërisë financiare dhe zhvillimit të sigurt të tregjeve financiare jobankare.

Kjo strategji vendos theks të veçantë në integritetin e tregjeve dhe rritjen e besueshmërisë së konsumatorit e investitorit, si dhe projekton shtyllat e zhvillimit dhe promovimit të tregjeve financiare jobankare.

Stabiliteti makroekonomik, një kuadër i fortë ligjor dhe rregullator, janë elementë të rëndësishëm për të rritur besimin e konsumatorëve dhe investitorëve vendas dhe të huaj.

IV. PRIORITETET STRATEGJIKE DHE NDËRSEKTORIALE

PRIORITETET STRATEGJIKE

1. FORCIMI I STABILITETIT FINANCIAR, RRIJJA E EFEKTIVITETIT TË MBIKËQYRJES DHE INTEGRITETI I TREGJEVE

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare do të vijojë të kontribuojë në nxitjen e qëndrueshmërisë dhe zhvillimin e sigurt të tregjeve financiare nën mbikëqyrje, duke luajtur rol proaktiv në funksion të mirërregullimit dhe zhvillimit të këtyre tregjeve.

Prioritet i Autoritetit do të jetë forcimi i mëtejshëm i funksionit të tij mbikëqyrës, duke zhvilluar dhe zbatuar mbikëqyrjen me bazë rreziku dhe përafrimi me standardet ndërkombëtare.

Autoriteti, me qëllim avancimin drejt standardeve më të mira ndërkombëtare në fushën e sigurimeve, do të finalizojë një vlerësim të plotë të përputhshmërisë së bazës ligjore dhe rregullatore, si dhe praktikave mbikëqyrëse të tij me Parimet Themelore Ndërkombëtare në Sigurime (ICP). Në bashkëpunim me ekspertët e Bankës Botërore, Autoriteti do të punojë për implementimin e udhërrëfyesit drejt regjimit evropian të mbikëqyrjes në sigurime, Solvency II, si angazhim i Shqipërisë në kuadrin e anëtarësimit në BE.

Do të synohet finalizimi dhe implementimi i strategjisë për zhvillimin e tregjeve të kapitalit në drejtim të rritjes së pjesëmarrjes së emetuesve, zgjerimit të gamës së instrumenteve financiare, përmirësimit të efciencës së tregut dhe zgjerimit të bazës së investitorit. Për të arritur këtë, Autoriteti do të vijojë bashkëpunimin me institucionet me rol kyç për zhvillimin e tregut (Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Banka e Shqipërisë), si dhe me aktorët e tregut, apo institucione ndërkombëtare.

Qëllim kryesor mbetet mbikëqyrja e kujdesshme e tregjeve dhe monitorimi i treguesve kryesorë financiarë, integriteti, transparenca dhe forcimi i kontroleve të brendshme dhe të jashtme, me qëllim ruajtjen e stabilitetit dhe shëndetshmërisë së subjekteve nën mbikëqyrje. Autoriteti do të vijojë bashkëpunimin ndërinstytucional lidhur me çështjet e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

1.1 Ruajtja dhe forcimi i stabilitetit financiar

AMF ndërvepron dhe koordinon punën me Ministrinë e Financave dhe Bankën e Shqipërisë në funksion të garantimit të stabilitetit financiar të vendit. Këto institucione janë pjesë e Grupit Këshillimor për Stabilitetin Financiar (GKSF), që funksionon si një njësi këshillimore, për zhvillimin e politikave të përbashkëta, bashkëpunimin dhe bashkërendimin e veprimeve të anëtarëve të këshillit; në ruajtjen, stabilitetin dhe zhvillimin e tregjeve financiare në Republikën e Shqipërisë; në përmirësimin dhe rritjen e efikasitetit të kontrollit mbi pjesëmarrësit e tregjeve financiare; kryerjen e inspektimeve të përbashkëta në subjektet e mbikëqyrura, si dhe siguron shkëmbimin e informacionit ndërmjet anëtarëve të grupit.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare do të thellojë ndërveprimin me Ministrinë e Financave edhe në kuadër të zbatimit të dokumentit të politikave për zhvillimin e tregjeve të kapitalit.

Autoriteti, do të vijojë gjithashtu bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit me Bankën e Shqipërisë, do të forcojë mbikëqyrjen e përbashkët, në funksion të monitorimit të tregjeve nën mbikëqyrje, për garantimin e stabilitetit financiar.

1.2 Rritja e efektivitetit të veprimtarisë mbikëqyrëse të tregjeve

1.2.1 Forcimi i proceseve mbikëqyrëse drejt standardeve më të mira ndërkombëtare

Prioritet i punës së Autoritetit do të mbetet mbikëqyrja e kujdesshme e tregjeve dhe treguesve kryesorë financiarë të subjekteve nën mbikëqyrje, marrë në konsideratë edhe efektet vijuese të shkaktuara nga faktorët e jashtëm e të brendshëm, si dhe zhvillimet në tregjet financiare ndërkombëtare.

Autoriteti do të thellojë marrëdhëniet dhe bashkëpunimin me partnerët financiarë ndërkombëtarë, si Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe organizmat e tjera ndërkombëtare si IAIS, IOPS/OECD, IOSCO, EIOPA, ESMA, institucionet homologe të rajonit dhe më gjerë, në funksion të shkëmbimit të informacionit dhe eksperiencës, si edhe rritjes së efektivitetit të mbikëqyrjes.

Në fushën e sigurimeve, Autoriteti do të fokusohet në përafrimin e mëtejshëm me Parimet Themelore në Sigurime (ICP), si standarde të njohura ndërkombëtarisht në fushën e mbikëqyrjes së sigurimeve, si dhe do të ndjekë praktikën më të mira globale në mbikëqyrjen e sigurimeve.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, me kërkesë të tij, gjatë vitit 2022 iu nënshtrua një procesi rigoroz vlerësimi të përputhshmërisë me ICP-të, nga Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve në Sigurime (IAIS). Vlerësimi përfshiu aspektin ligjor dhe rregullator, pavarësinë institucionale, praktikën mbikëqyrëse, proceset e analizës dhe vlerësimit të rrezikut, procedurat e licencimit, mbikëqyrjen e grupeve të sigurimit, etj. Raporti i vlerësimit të përputhshmërisë me këto parime bazë në sigurime, do të miratohet nga Komiteti Ekzekutiv i IAIS-it gjatë vitit 2023.

Në linjë me rekomandimet e raportit të vlerësimit nga IAIS, Autoriteti do të angazhohet në rishikimin e kuadrit ligjor e rregullator, si dhe të praktikave mbikëqyrëse në fushën e sigurimeve, me synim përafrimin e mëtejshëm me ICP-të.

Në tregun e sigurimeve, Autoriteti do të përmirësojë metodologjinë mbikëqyrëse me bazë rreziku, në drejtim të rishikimit të treguesve të paralajmërimit të hershëm, në funksion të vlerësimit të profilit të rrezikut në nivel shoqërie dhe tregu. Qëllimi është ndërtimi i një sistemi mbikëqyrës efektiv, ku treguesit e paralajmërimit të hershëm të mundësojnë shpërndarjen efektive të burimeve të Autoritetit, adresimin në kohë të problematikave dhe parandalimin në fazë të hershme të problemeve financiare të shoqërive të sigurimit. Metodologjia e mbikëqyrjes me bazë rreziku do të përfshijë tregues shtesë, si dhe do të zbatohet nëpërmjet një moduli interaktiv, i cili përmbledh: (a) përfshirjen e treguesve dhe të referencës për tregun (benchmarks); (b) analizën shtesë të të dhënave të tregut; (c) strukturimin dhe standardizimin e matricës së rrezikut për vlerësimin e rrezikut në nivel shoqërisht individuale; dhe (d) përfshirjen e një spektri të rrezikut për të gjithë tregun e sigurimit Jo-Jetë.

Gjithashtu synohet automatizimi i këtij sistemi, gjë që do të mundësojë marrjen në kohë të informacionit të nevojshëm dhe ndërhyrjen me masa mbikëqyrëse sipas rastit.

Mbikëqyrja e grupeve të sigurimit do të fokusohet në përmirësimin e kërkesave rregullatore lidhur me treguesit në nivel grupi, kërkesa të shtuara për përshtatshmëri të personave kyç të grupit, si dhe kërkesa të shtuara lidhur me qeverisjen korporative.

Në tregun e kapitaleve, Autoriteti do të fokusohet në forcimin e mbikëqyrjes prudenciale të subjekteve. Për këtë qëllim do të synohet krijimi i formateve standarde të raportimit, me anë të të cilave do të mblidhet informacioni i nevojshëm për kryerjen e analizave të subjekteve, për të siguruar pajtueshmërinë e tyre me kërkesat ligjore dhe rregullatore.

Autoriteti, për të vlerësuar dhe parandaluar rastet e abuzimit me tregun, ndër të tjera do të vlerësojë mundësinë e krijimit të një sistemi apo mekanizmi për identifikimin në kohë dhe monitorimin e rasteve, që mund të përbëjnë manipulim të tregut.

Në drejtim të forcimit të mëtejshëm të mbikëqyrjes, do të vijojë puna për finalizimin e një manuali për zbatueshmërinë, i cili do të shërbejë në rastet e hetimit të subjekteve të tregjeve të kapitalit, që nuk përmbushin apo nuk respektojnë kërkesat ligjore dhe rregullatore. Ky udhëzues do të përmbajë procedurat, linjat e komunikimit, si dhe kriteret për përcaktimin e masave administrative apo sanksionet përkatëse në këto raste.

Për arritjen e objektivave të mësipërme, Autoriteti do të bazohet edhe në dokumentet e hartuara në kuadër të projekteve të asistencës teknike të huaj dhe me mbështetje nga Banka Botërore.

Plotësimi i gjithë kuadrit rregullator në zbatim të ligjit të ri për tregjet e kapitalit, përafrimi i mëtejshëm me Direktivat Evropiane të fushës, do të shërbejnë për të rritur më tej standardet e mbikëqyrjes mbi subjektet që operojnë në tregjet e kapitalit.

Në tregjet financiare të bazuar në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë, Autoriteti do të punojë në drejtim të përafrimit të legjislacionit shqiptar me *acquis* të BE, rregulloren më të fundit evropiane për tregjet e krypto-aseteve “Markets in Crypto-assets (MiCA)”.

Autoriteti në bashkëpunim me institucionet përkatëse, pas shqyrtimit të shkallës së përputhshmërisë së kësaj rregulloreje me legjislacionin shqiptar, do të vlerësojë dhe do të përgatisë ndryshimet ligjore përkatëse.

Autoriteti synon finalizimin dhe implementimin e strategjisë për zhvillimin e tregjeve të kapitalit me qëllim rritjen e pjesëmarrjes së emetuesve, zgjerimit të gamës së instrumenteve financiare, përmirësimit të eficiencës së tregut dhe zgjerimit të bazës së investitorit. Për këtë, Autoriteti do të vijojë bashkëpunimin ndërinstucional me Ministrinë e Financave, Bankën e Shqipërisë, si dhe me aktorët e tregut apo institucione ndërkombëtare.

Në tregun e sipërmarrjeve të investimeve kolektive, zbatimi i Manualit të Mbikëqyrjes me bazë rreziku mbetet një ndër objektivat kryesore në drejtim të forcimit të mbikëqyrjes. Kjo qasje e re mbikëqyrëse do të sigurojë ndërhyrje efikase dhe në kohën e duhur, mbrojtjen e interesave të investitorëve, duke promovuar qëndrueshmëri, transparencë, besueshmëri në treg. Aplikimi i kësaj metodologjie në tregun e Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive (SIK), do të shërbejë për një qasje të fokusuar në ato shoqëri administruese dhe depozitarë me nivel më të lartë rreziku, duke i dhënë përparësi shpërndarjes së burimeve mbikëqyrëse të subjektet me risk më të lartë.

1.2.2 Implementimi i udhërrëfyesit drejt regjimit Solvency II, në tregun e sigurimeve

Zbatimi i regjimit mbikëqyrës *Solvency II* është një nga prioritetet kryesore të AMF-së dhe një detyrim në kuadrin e anëtarësimit në BE. Referuar eksperiencës evropiane, procesi i implementimit të *Solvency II* në tregun shqiptar të sigurimeve duhet të jetë një proces gradual, efikas dhe i zbatueshëm.

Kalimi drejt regjimit të mbikëqyrjes *Solvency II*, i cili krijon një sistem modern të bazuar mbi riskun, pritet të sjellë avantazhe konkurruese për siguruesit, të kontribuojë në zhvillimin e sektorit të sigurimeve, si dhe të promovojë më tej rolin e sigurimeve në ekonominë e vendit.

Autoriteti përgjatë viteve të ardhshme synon implementimin e udhërrëfyesit (roadmap) të detajuar, përgatitur me asistencë teknike të Bankës Botërore dhe miratuar nga Bordi i Autoritetit.

Regjimi *Solvency II* parashikon kërkesa të reja dhe komplekse, në nivel teknik dhe organizativ, për shoqëritë e sigurimit dhe AMF-në. Prandaj është thelbësore planifikimi i veprimeve përgatitore, që lidhen me implementimin e elementëve të tre shtyllave të këtij regjimi, ku ndër të tjera përfshihen: vlerësimi i pasqyrave financiare me bazë rreziku, raporti i vetëvlerësimit të riskut dhe kërkesave për kapital (ORSA), kryerja e vlerësimit të impaktit sasior të kërkesave për kapital, vlerësimi i kërkesave për një qeverisje korporative dhe administrim të mirë të rrezikut, etj. Zhvillimi i kapaciteteve të duhura mbikëqyrëse nëpërmjet trajnimeve të dedikuara, përfshirë edhe ato në fushën aktuariale, mbetet një nga sfidat e Autoritetit për zbatimin e regjimit mbikëqyrës *Solvency II*.

Sipas udhërrëfyesit, nga momenti i fillimit të aplikimit të tij, deri në zbatimin e plotë të regjimit *Solvency II*, planifikohet një periudhë shtatë vjeçare. Aktivitetet përgatitore planifikohen të shtrihen në pesë vjet, ndërkohë që viti i gjashtë planifikohet për miratimin e rregulloreve dhe do të shërbejë gjithashtu si një vit ushtrimor, ku siguresit do të raportojnë sipas *Solvency II*. Objektivi është fillimi i implementimit të regjimit *Solvency II* në vitin e shtatë.

1.3 Integriteti i tregjeve

1.3.1 Rritja e transparencës

Integriteti i tregjeve të kapitalit përbën themelin për tregje eficiente dhe të mirëregulluara, duke siguruar akses të barabartë për pjesëmarrësit, praktika të drejta tregtimi dhe përmbushje të standardeve të larta të qeverisjes korporative në mbrojtje të investitorit dhe rritjes së besimit në tregjet dhe institucionet financiare.

Në kuadër të rritjes së transparencës dhe me qëllim rritjen e integritetit të tregjeve të kapitalit Autoriteti do të mbështesë krijimin e një sistemi qendror për depozitimin dhe ruajtjen e informacionit që publikohet nga shoqëritë e listuara, në mënyrë që të mund të aksesohet në çdo kohë nga të gjitha palët e interesuara. Ky sistem do të jetë në përputhje me standardet për cilësinë e sigurisë, besueshmërinë e burimit të informacionit, kohën e regjistrimit dhe lehtësinë e aksesit nga përdoruesit përfundimtarë.

Transparenca dhe besimi janë thelbësore edhe për integritetin dhe zhvillimin e tregjeve të fondeve të pensionit privat dhe të atij të SIK. Ligji 56/2020 “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive” ka shtuar dhe forcuar kërkesat për transparencë ndaj investitorëve të SIK me ofertë publike, si dhe kërkesat për raportim financiar në Autoritet nga ana e shoqërive administruese. Zbatimi i këtyre kërkesave të shtuara për transparencë sipas kuadrit të ri ligjor e rregullator nga ana e shoqërive administruese të SIK, do të jetë në fokusin e punës mbikëqyrëse të Autoritetit në vitet në vijim.

Në Projektligjin “Për fondet e pensioneve private” që pritet të miratohet gjatë vitit 2023 nga Kuvendi i Shqipërisë, janë rritur kërkesat për transparencë dhe për informim të anëtarëve të fondeve të pensionit. Me miratimin e projektligjit, Autoriteti do të bashkëpunojë me shoqëritë administruese të fondeve të pensionit për realizimin e procesit të përshtatshmërisë të aktivitetit të tyre me kërkesat e reja ligjore dhe rregullatore për transparencë.

1.3.2 Monitorimi i abuzimit me tregun

Sjelljet abuzive në treg çenojnë integritetin e sistemit financiar, duke dëmtuar interesat e investitorit. Këto sjellje mund të çojnë në mungesë besimi në tregjet e kapitalit, risk më të lartë, apo dhe ulje të pjesëmarrjes së investitorëve në tregjet e rregulluara.

Autoriteti, me qëllim ruajtjen e integritetit të tregjeve, synon të sigurojë zbatimin nga të gjitha institucionet të procedurave dhe masave për zbulimin dhe parandalimin në kohë të praktikave të manipulimit të tregut. Gjithashtu, Autoriteti duhet të sigurojë që emetuesit e titujve të publikojnë informacionin e privilegjuar, sa më parë, të plotë, të vërtetë dhe të saktë.

Lidhur me nevojën për monitorimin e rasteve të abuzimeve me tregun, është përgatitur me asistencë teknike të huaj, një raport, i cili hedh bazat për vlerësimin dhe parandalimin e rasteve të abuzimit me tregun. Në këtë kuadër, Autoriteti do të miratojë rregullat, kriteret dhe procedurat e nevojshme për të parandaluar, identifikuar, apo raportuar këto raste.

Përgjatë periudhës 2023-2027, objektivi është ndërtimi i një sistemi apo mekanizmi për të mbledhur dhe analizuar inputet e nevojshme nga burime të ndryshme informacioni të disponueshëm dhe të përshtatshëm, për të zbuluar në kohë rastet e dyshimta që mund të çojnë në abuzim të tregut.

1.3.3 Forcimi i kontrolleve dhe qeverisjes korporative

Qeverisja korporative është element kyç për të siguruar integritet dhe një drejtim efektiv të shoqërisë, duke kontribuar në rritjen e përgjegjësisë, transparencës dhe besimit në treg. Kjo ndikon në rritjen e kërkesës së investitorëve për të investuar në aksione të shoqërive të listuara në Bursë. Një qeverisje e fortë korporative mbron interesat e aksionerëve dhe siguron që ato të jenë në linjë me interesat e vetë shoqërisë.

Hartimi i një kodi të qeverisjes korporative, si një praktikë e ndjekur në vendet e Bashkimit Evropian, kthehet në domosdoshmëri edhe për tregun shqiptar të kapitaleve. Qëllimi i hartimit të një kodi të qeverisjes korporative është maksimizimi i suksesit afatgjatë të organizatës, duke krijuar vlerë të qëndrueshme për aksionerët e saj dhe të gjithë palët e interesuara.

Në këtë drejtim, një nga objektivat e Autoritetit është bashkërendimi i punës me institucionet e tregut të kapitaleve për hartimin e një kodi të qeverisjes korporative për shoqëritë e listuara, me qëllim krijimin dhe promovimin e standardeve më të larta të qeverisjes korporative, menaxhimit të riskut dhe të sjelljes.

Gjithashtu, në vëmendje do të jetë forcimi i standardeve sa i përket ndërveprimit të subjekteve të licencuara me klientët, me qëllim mbrojtjen e tyre. Në këtë rast, subjektet hartojnë rregulla/procedura të brendshme në lidhje me mënyrën e vlerësimin të përshtatshëmrisë së klientit ndaj shërbimit dhe instrumentit financiar që i ofrohet, duke kryer kështu kategorizimin e investitorit.

Projektligji “Për fondet e pensionit privat” bazuar në Direktivën e BE 2016/2341 “Për veprimtaritë dhe mbikëqyrjen e institucioneve të pensionit profesional”, synon nxitjen e qëndrueshmërisë dhe mirëqeverisjes së shoqërive administruese të fondit të pensionit, si dhe rregulla të reja sipas Direktivës IORP II, lidhur me strukturat e kontrollit të brendshëm, përputhshmërinë, si dhe administrimin apo vetëvlerësimin e rrezikut.

Për tregun e sigurimeve, në linjë me parimet themelore të sigurimeve, Autoriteti synon të zgjerojë parashikimet rregullatore në drejtim të forcimit të qeverisjes korporative, duke u përqendruar në rritjen e transparencës lidhur me politikat e shpërblimit të aplikuara nga shoqëritë e sigurimit, shtrirjen e zbatimit të kërkesave për aftësi dhe përshtatshmëri edhe për funksionarët kyç të shoqërsë. Ky objektivi i paraprin edhe kërkesave të parashikuara në shtyllën e dytë të regjimit *Solvency II*, për mirëqeverisje dhe administrim më të mirë të rrezikut.

1.3.4 Parandalimi i pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare është pjesë e grupit ndërinstitucional, ngritur me Vendimin nr.1, datë 19.2.2020 të Komitetit të Bashkëndimit të Luftës kundër Pastrimit të Parave, për ndjekjen dhe përmbushjen e rekomandimeve të lëna nga Grupi i Posaçëm i Veprimit Financiar (FATF) dhe Grupi i Shqyrtimit të Bashkëpunimit Ndërkombëtar (ICRG). Autoriteti ka dhënë kontribut dhe ka zbatuar Planin e Veprimit të ICRG/FATF në periudhën 2020-2022.

Autoriteti, lidhur me çështjet e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit do të adresojë rekomandimet e lëna nga Komiteti MONEYVAL i Këshillit të Evropës, në lidhje me masat e marra kundër PPP/FT.

Autoriteti, ofron një qasje mbikëqyrëse të bazuar në rrezik, në bazë të standardeve më të mira ndërkombëtare, për administrimin efektiv të rreziqeve që vijnë nga pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit. Në këtë kuadër, do të vijojnë inspektimet tematike në subjektet e mbikëqyrura lidhur me praktikën dhe procedurat për adresimin e risqeve të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, si dhe do të monitorohet plotësisht i kërkesave ligjore gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre. Këto inspektime do të realizohen në mënyrë të pavarur, apo edhe në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Pastrimit të Parave dhe Bankën e Shqipërisë. Gjithashtu, një rëndësi e veçantë do t'i kushtohet trajnimeve dhe rritjes së ndërgjegjësimit lidhur me çështjet e PPP/FT.

Kuadri rregullator i tregjeve financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë dhe parandalimit të pastrimit të parave ngarkon disa institucione përgjegjëse për rregullimin e këtij ekosistemi në Shqipëri, bashkëpunimi ndërinstitucional është një nga elementët kyç në sigurimin e një mbikëqyrjeje efektive të këtyre tregjeve, lidhur me çështjet e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

2. PËRAFRIMI I LEGJISLACIONIT ME STANDARDET EVROPIANE, ZHVILLIMI DHE MODERNIZIMI I TREGJEVE

Në korrik 2022 u mbajt në Bruksel, Konferenca e Parë Ndërqeveritare midis Shqipërisë dhe BE-së, që shënoi hapjen zyrtare të bisedimeve për anëtarësim të vendit tonë në Bashkimin Evropian.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare është institucioni drejtues i Kapitullit 9 “Shërbimet Financiare” dhe kryesoi delegacionin shqiptar që mori pjesë në datat 13-14 shkurt 2023 në takimet bilaterale Shqipëri-BE. Grupi negociator, përbëhet nga përfaqësues të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Bankës së Shqipërisë dhe Agjencisë së Sigurimit të Depozitave.

Autoriteti në bashkëpunim me institucionet kontribuuese të Kapitullit 9, ka realizuar koordinimin, raportimet dhe takimet e posaçme në nënkomitete, si dhe ndjek në vazhdimësi realizimin e planit kombëtar të integritimit.

Autoriteti është gjithashtu pjesë e grupeve ndërinstitucionale të punës në kuadër të integritimit evropian dhe kontribuon në kapitujt: Kapitulli 2- Liria e lëvizjes së punëtorëve, Kapitulli 3- Liria për të ofruar shërbime, Kapitulli 4 -Lëvizja e lirë e kapitalit, Kapitulli 6- Legjislacioni për shoqëritë tregtare, Kapitulli 17- Politika ekonomike dhe monetare dhe Kapitulli 28- Mbrojtja e konsumatorit.

Kontributi i AMF përsa i përket përafrimit të kuadrit ligjor me acquis, është theksuar edhe në Progres Raportet e Komisionit Evropian. Autoriteti do të vijojë punën për harmonizimin e mëtejshëm të legjislacionit të brendshëm të shërbimeve financiare me acquis, duke mbajtur parasysh edhe rekomandimet e Raportit të KE-së, pas takimeve Bilaterale në Bruksel.

Avancimi i legjislacionit drejt standardeve evropiane krijon mundësi të reja për zhvillim dhe modernizim të tregjeve financiare jobankare. Autoriteti do të mbështesë zhvillimet në tregje dhe do të bashkëpunojë me institucionet dhe palët e interesit në këtë drejtim.

2.1 Përafrimi i legjislacionit me Direktivat Evropiane

Në drejtim të harmonizimit me Direktivat Evropiane, **është** bërë progres në përafrimin e legjislacionit në fushën e fondeve të investimit, të fondeve të pensioneve private, tregut të titujve dhe tregut të sigurimeve.

Autoriteti do të kompletojë bazën e nevojshme nënligjore, në zbatim të ligjeve të reja për tregjet e kapitalit dhe për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë, mbështetur në direktivat dhe praktikatat më të mira evropiane.

Në tregun e pensioneve vullnetare, projektligji “Për fondet private të pensionit”, është hartuar me një nivel të lartë përafrimi me direktivat evropiane, në veçanti me Direktivën 2016/2341/KE “Për veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e Institucioneve të Pensionit Profesional” (IORP II). Objektivi do të jetë plotësimi i të gjithë kuadrit rregullator në zbatim të ligjit të ri, pas miratimit të tij nga Kuvendi i Shqipërisë.

Në tregun e fondeve të investimeve, Autoriteti do të miratojë akte nënligjore që do të mundësojnë kryerjen e aktivitetit ndërkufitar me vendet e BE-së në këtë fushë. Këto akte rregullatore lidhen me: i) procedurat, rregullat dhe informacionin e nevojshëm për njohjen e shoqërive administruuese, degëve të tyre dhe SIK me ofertë publike të licencuara në BE për marketim dhe shitje në Republikën e Shqipërisë; dhe ii) rregullat për regjistrimin e personave juridikë që do të marketojnë dhe shesin kuotat e SIK me ofertë publike, të licencuara në vendet anëtare të BE-së.

Në tregun e sigurimeve, zbatimi i *Solvency II* është një nga prioritetet kryesore të AMF-së në kuadër të procesit të integritimit në BE. Regjimi *Solvency II* pritet të sjellë ndryshime thelbësore në kulturën dhe mënyrën e administrimit të rrezikut nga ana e shoqërive të sigurimit. Pjesë e objektivave afatmesme të Autoritetit është edhe përgatitja e projektigjit të ri “Për Veprimtarinë e Sigurimeve dhe Risigurimeve”, për të përafuar më tej ligjin në fuqi me direktivat evropiane në fushën e sigurimeve dhe parimet themelore ndërkombëtare të sigurimeve.

Në tregun e kapitaleve, plotësimi i kuadrit rregullator përmes miratimit të projektregulloreve të hartuara në zbatim të Ligjit nr. 62/2020 “Për Tregjet e Kapitalit”, përbën prioritet për Autoritetin, në funksion të rregullimit dhe forcimit të mbikëqyrjes në fushën e tregjeve të kapitalit. Projektregulloret e hartuara me asistencë të huaj teknike janë përafuar ndjeshëm me rregulloret dhe direktivat e Bashkimit Evropian, duke vendosur standarde evropiane në praktikën e rregullimit dhe mbikëqyrjes.

Gjithashtu gjatë periudhës 2023-2027, Autoriteti në bashkëpunim me institucione të tjera me rol kyç në tregjet e kapitalit, do të analizojë mundësinë për hartimin e një legjislacioni të posaçëm për Obligacionet e Mbuluara (Covered Bonds), në përputhje me Direktivën e Bashkimit Evropian për këtë instrument financiar. Hartimi i këtij legjislacioni merr rëndësi jo vetëm në nivel evropian në kuadër të agjendës së BE-së për një treg të bashkuar kapitalesh, por edhe në nivel kombëtar në funksion të krijimit të instrumenteve të reja financiare dhe zhvillimit të tregut vendas të kapitalit.

Në tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë, Autoriteti do të punojë në drejtim të përafrimit të legjislacionit shqiptar me *acquis* të BE, rregulloren më të fundit evropiane për tregjet e kripto-aseteve “Markets in Crypto-assets (MiCA)”, me qëllim rregullimin e ekosistemit të kripto-aseteve, dhe fokus të veçantë tek kërkesat prudenciale për ofruesit e shërbimeve të lidhura me kripto-asetet, mbrojtje më të mirë të konsumatorit, parandalimin e pastrimit të parave dhe qëndrueshmërinë e sistemeve.

Kjo rregullore, e cila pritet të hyjë në fuqi në fillim të vitit 2023, është pjesë e një pakete rregulloresh (*Digital Finance Package*) miratuar nga Komisioni Evropian, të cilat synojnë të përmirësojnë konkurrueshmërinë e sektorit FinTech në Evropë, duke adresuar njëkohësisht risqet dhe çështjet e stabilitetit financiar në ekonomitë e BE-së.

Autoriteti në bashkëpunim me institucionet përkatëse, pas shqyrtimit të shkallës së përpunueshmërisë së kësaj rregulloreje me legjislacionin shqiptar, do të vlerësojë dhe do të përgatisë ndryshimet ligjore përkatëse.

2.2 Mbështetja e zhvillimit dhe modernizimit të tregjeve

Diversifikimi i sistemit financiar nëpërmjet zhvillimit të tregjeve financiare jobankare, synon mbështetjen e rritjes ekonomike të qëndrueshme, si dhe rritjen e konkurrueshmërisë në nivel kombëtar.

Ndërlidhja me tregjet ndërkombëtare dhe evropiane, zgjerimi i alternativave të investimit dhe instrumentave financiarë, rritja e aksesueshmërisë, e transparencës, besimit dhe mbrojtjes së investitorëve, kontribuojnë në zhvillimin e mëtejshëm të tregut të kapitaleve. Gjithashtu, operatorët e tregut të sigurimeve, fondeve të investimit dhe fondeve private të pensionit janë investitorë institucionalë të rëndësishëm dhe zhvillimi i këtyre tregjeve, do t'i jepte hov zhvillimit të tregut vendas të kapitaleve.

Në tregun e sigurimeve, synohet rritja dhe zhvillimi i këtij tregu, nëpërmjet zhvillimit të produkteve të reja që plotësojnë kërkesat e konsumatorit, përmirësimit të produkteve ekzistuese, formave të reja të shpërndarjes dhe marketimit të produkteve, me qëllim zgjerimin e bazës së personave të siguruar dhe rritjen e nivelit të përfshirjes financiare.

Autoriteti vlerëson gjithashtu se zhvillimi i produkteve të sigurimit gjithëpërfshirës (*inclusive insurance*) do të ndikojë jo vetëm në zgjerimin dhe diversifikimin e tregut të sigurimeve, por edhe në përmbushjen e objektivave sociale për grupe të caktuara të shoqërisë. Autoriteti do të mbështesë iniciativat për zhvillimin e produkteve të reja të sigurimit në të dy segmentet, Jetë dhe Jo-Jetë, në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregullatore në fuqi.

Sa i takon produkteve të sigurimit të detyrueshëm, objektiv i Autoritetit do të jetë forcimi i bashkëpunimit me institucionet shtetërore përgjegjëse për monitorimin e produkteve të sigurimit të detyrueshëm, me qëllim zbatimin e kuadrit ligjor, që lidhet kryesisht me sigurimin e përgjegjësiwe profesionale dhe civile.

Autoriteti do të vijojë bashkëpunimin me Bankën Botërore, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe do të jetë në konsultim me palët e interesit, për të avancuar punën në lidhje me projektligjin “Për sigurimin e detyrueshëm të banesave nga tërmeti”.

Për sa i përket **tregut të kapitaleve**, Autoriteti përgjatë periudhës 2023-2027 do të vijojë të ketë prioritet rolin e tij proaktiv në sigurimin e eficiencës, integritetit dhe zhvillimit të tregjeve të kapitalit në vend. Tregu i kapitaleve ndihmon në diversifikimin e sistemit financiar dhe burimeve të financimit dhe zbutjen e ekspozimit ndaj riskut sistematik.

Me lëvizjen e lirë të kapitalit dhe ndërveprimin me tregjet e huaja, tregu shqiptar i kapitaleve duhet të bëhet tërheqës edhe për investitorë jashtë vendit, përfshirë edhe investimet nga diaspora shqiptare. Nisur nga rëndësia e tij si burim potencial ende i pashfrytëzuar, synohet kthimi i tregjeve të kapitalit në një alternativë të qëndrueshme financimi, përkundrejt burimeve tradicionale të financimit dhe vënia e këtyre tregjeve në funksion të ekonomisë, si edhe tërheqja e investimeve të huaja.

Për këtë qëllim, do të vijojë zbatimi i planeve të veprimit, të përcaktuara në dokumentin politik për zhvillimin e tregjeve të kapitalit, hartuar nga Autoriteti në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. Koordinimi ndërinstitutional dhe dialogu i përbashkët do të fokusohen në drejtim të rritjes së pjesëmarrjes së emetuesve dhe listimit të kompanive shqiptare në Bursë; zgjerimit të gamës së instrumenteve financiare; përmirësimit të mëtejshëm të eficiencës së tregjeve të kapitalit përmes digjitalizimit dhe teknologjive të reja në shërbimet financiare (Fintech), zgjerimit të bazës së investitorit, si edhe ndërgjegjësimit të publikut dhe emetuesve për avantazhet e aksesit në tregjet e kapitalit.

Për sa i përket **tregut të fondeve të pensioneve private**, miratimi i projektligjit “Për fondet e pensionit privat”, i cili është në përputhje me Direktivën Evropiane IORP II, pritet të sjellë zhvillim të këtij tregu nëpërmjet rritjes së pjesëmarrjes në skemë. Ky projektligj parashikon krijimin e formave të reja të fondeve të pensionit privat, përfshirjen automatike të punonjësve në raste të caktuara, lehtësira fiskale, kërkesa më të larta për transparencë, politika të reja investimi të aseteve të fondit, si dhe reduktim të barrierave për shërbime ndërkufitare.

Autoriteti pas miratimit të ligjit nga Kuvendi i Shqipërisë, krahas punës për plotësimin e të gjithë kuadrit rregullator në zbatim të tij, do të angazhohet në monitorimin e procesit të përshtatshmërisë të aktivitetit të shoqërive administruese me kërkesat e reja ligjore dhe rregullatore, si dhe zbatueshmërinë e tyre.

Në tregun e fondeve të investimit, Ligji 56/2020 “Për Sipëmarrjet e Investimeve Kolektive” parashikon krijimin e formave dhe strukturave të reja të organizimit të SIK, siç janë: sipëmarrjet me pjesëmarrje të mbyllur, të cilat mund të themelohen si shoqëri tregtare (shoqëri e investimeve me kapital fik), ose në formë kontraktore (fondet e investimeve), fondet me intervale në formë kontraktore, sipëmarrjet ombrellë, sipëmarrjet kryesore, sipëmarrjet furnizuese të investimeve kolektive. Gjithashtu, kuadri i ri ligjor bën të mundur njohjen e SIK të huaja në tituj të transferueshëm ose jo, me ofertë publike.

Parashikimi në ligj i formave dhe strukturave të reja të SIK përbën potencial për zhvillimin e këtij tregu, duke krijuar mundësi të reja investimi për investitorët dhe qytetarët shqiptarë dhe duke rritur aksesin në burime të reja financiare për bizneset.

Në kuadrin e kryerjes së aktivitetit ndërkuftar, Autoriteti është angazhuar në lidhjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit me autoritetet rregullatore të vendeve të BE, si dhe në hartimin dhe miratimin e rregulloreve përkatëse në këtë drejtim. Këto rregullore bëjnë të mundur zbatimin e rregullave dhe procedurave të detajuara në lidhje me njohjen e shoqërive administruese të licencuara në vendet e BE-së, si dhe SIK me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike në tituj të transferueshëm të miratuara në vende të BE-së, si dhe agjentëve të shitjes së këtyre SIK në Republikën e Shqipërisë.

Zhvillimi i tregjeve të kapitalit me instrumenta të reja financiare, si bazë për investimet e aseteve të SIK, do të bëjë të mundur që sipërmarrjet e investimeve kolektive të jenë tërheqëse për investitorët, si dhe do të krijojë premisa për hyrjen në treg të llojeve të reja të SIK.

Arritja e objektivave të mësipërme për zhvillimin e tregjeve financiare jobankare kërkon bashkëpunim dhe angazhim të palëve të interesit, si dhe të institucioneve me rol kyç në këto tregje.

3. MBROJTJA E INTERESAVE TË KONSUMATORËVE DHE INVESTITORËVE, RITJA E PËRFSHIRJES FINANCIARE DHE EDUKIMI FINANCIAR

Mbrojtja konsumatore dhe sjellja e tregut në fushën e shërbimeve financiare janë në qendër të vëmendjes për të ndërmarrë nisma, që synojnë të adresojnë sfidat me të cilat përballen konsumatorët dhe përdoruesit e shërbimeve financiare.

Autoriteti, duke patur si objektiv themelor mbrojtjen e konsumatorit dhe investitorit, do të vijojë punën në drejtim të rritjes së kërkesave për transparencë dhe informacion, sipas standardeve ndërkombëtare. Veprimtaria e AMF-së do të përqendrohet në zbatimin e kërkesave të sjelljes së tregut (*market conduct*), të cilat konsiderohen të rëndësishme për zhvillim afatgjatë dhe të qëndrueshëm, duke siguruar mbrojtje të konsumatorit dhe investitorit.

Autoriteti në kuadër të strategjisë kombëtare për edukim dhe përfshirje financiare, do të bashkëpunojë me Bankën e Shqipërisë dhe institucione të tjera në vend, sa i përket nismave në funksion të edukimit financiar dhe rritjes së ndërgjegjësimit të publikut. Angazhimi dhe bashkëpunimi ndërinstitucional janë një garanci për të ndërtuar një platformë të qëndrueshme dhe me aktivitete të koordinuara, me qëllim ndërgjegjësimin e publikut dhe shtrirjen më të gjerë të kulturës financiare në vend.

Rritja e përfshirjes financiare në tregjet financiare jobankare mund të mbështetet përmes avancimit me sigurimet gjithëpërfshirëse, krijimit të produkteve të reja që i përshtaten nevojave të konsumatorit dhe investitorit, lehtësimin të aksesit në shërbimet financiare nëpërmjet digjitalizimit, etj. Autoriteti synon një qasje më të gjerë të publikut në produktet financiare.

Autoriteti do të ketë në fokus aktivitetet e edukimit financiar, përmirësimin e sistemit të ankesave për konsumatorët dhe investitorët, si dhe përmirësimin dhe pasurimin e faqes zyrtare të AMF me informacione të dedikuara për publikun.

3.1 Mbrojtja e interesave të konsumatorëve dhe investitorëve

3.1.1 Monitorimi i sjelljes së operatorëve të tregut

Në funksion të mbrojtjes së konsumatorëve dhe investitorëve, Autoriteti do të avancojë standardet rregullatore, duke rritur kërkesat për transparencë dhe informacion. Në këtë drejtim, AMF do të vijojë monitorimin e sjelljes së operatorëve të tregut, për të siguruar që në sektorin e sigurimeve, konsumatorët të pajisen me informacionin e nevojshëm në lidhje me kushtet e sigurimit, përfitimet apo përjashtimet që ata kanë, si dhe investitorët në tregun e fondeve të investimit të pajisen me informacionin e duhur dhe të nevojshëm për kryerjen e investimit.

Gjithashtu, Autoriteti do të monitorojë në vazhdim zbatimin e kërkesave ligjore dhe rregullatore nga shoqëritë komisionere/bankat që ofrojnë shërbime investimi, lidhur me kategorizimin e klientëve dhe informacionin e nevojshëm që iu vihet në dispozicion investitorëve, me qëllim marrjen e vendimeve të mirëinformuara nga ana e tyre. Kategorizimi i investitorëve në profesionistë dhe joprofesionistë, sipas nivelit të njohurive financiare dhe eksperiencës në fushën e investimeve, është një element i rëndësishëm në funksion të mbrojtjes së investitorëve. Shoqëritë që ofrojnë shërbime investimi kanë detyrimin, që nëpërmjet testeve të përshtatshme, të mbledhin informacion mbi investitorin, natyrën dhe profilin e tij të riskut, si dhe t'i ofrojnë investitorit informacion të detajuar mbi instrumentet financiare dhe nivelin e riskut të tyre.

Në qendër të vëmendjes do të jetë edhe monitorimi i produkteve që ju ofrohen online konsumatorëve dhe investitorëve. Me qëllim mbrojtjen e të siguruarit, do të vijojë monitorimi i faqeve të internetit të subjekteve nën mbikëqyrje, me qëllim që informacioni i dhënë për shoqërinë e sigurimit dhe produkteve që ofron, të jenë në një formë efikase dhe në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregullat për informim, të miratuara nga Autoriteti.

Objektiv është dhe forcimi i standardeve për rregullimin dhe monitorimin e praktikave promovionale të shoqërive që operojnë në tregjet nën mbikëqyrje, veçanërisht për produkte të reja dhe specifike, në tregun e sigurimeve, fondet e investimeve, fondet private të pensioneve, si dhe shërbimet e investimit, me qëllim mbrojtjen më të mirë të konsumatorëve dhe investitorëve.

Autoriteti do të vazhdojë të angazhohet në publikimin e paralajmërimeve në faqen zyrtare në situata të veçanta, lidhur me shërbime apo produkte investimi që paraqesin risk të shtuar për investitorët. Këto paralajmërime kanë si qëllim të tërheqin vëmendjen e publikut për rreziqet që mbartin instrumenta financiare të caktuara, apo dhe në rast se ofrimi i shërbimeve financiare vjen nga shoqëri të palicencuara, të paregjistruara apo të panjohura, sipas parashikimeve ligjore të fushës.

3.1.2 Modernizimi i sistemeve për trajtimin e ankesave

AMF disponon një sistem qendror të ankesave për konsumatorët dhe klientët e shoqërive të mbikëqyrura. Çdo ankimues pajiset me një kod unik të ankesës, nëpërmjet të cilit mund të ndjekë trajtimin e ankesës së tij në çdo fazë. Në fokus të punës do të jetë zhvillimi dhe përmirësimi i mëtejshëm i sistemit të ankesave, për të përmirësuar dhe thjeshtëzuar mënyrën e përdorimit të tij për konsumatorët dhe investitorët. Shoqëritë e mbikëqyrura janë të detyruara me ligj të kenë sistemin e tyre të ankesave, ku evidentohen ankesat e klientëve dhe trajtimi i tyre deri në zgjidhjen përfundimtare.

Autoriteti do të vijojë të ketë në fokus monitorimin e tyre për të siguruar që këto sisteme janë ngritur nga shoqëritë dhe funksionojnë në mënyrë efektive dhe efikase. Objektiv është edhe shtimi i kërkesave rregullatore për sistemin e ankesave të shoqërive. Për të përmirësuar administrimin e ankesave, synohet digjitalizimi i regjistrit të ankesave të shoqërive, në mënyrë që të jetë i aksesueshëm nga Autoriteti, sikurse regjistri i dëmeve. Kjo gjë do të mundësojë kryerjen e analizave cilësore dhe sasiore të ankesave të depozituara nga klientët pranë shoqërive, me qëllim evidentimin e shkaqeve të ankesave, mangësitë e produktit ose procesit, si dhe problematikat dhe mangësitë në shoqëri, dhe marrjen e masave për korrigjimin e tyre dhe përmirësimin e situatave.

3.1.3 Skemat mbrojtëse të kompensimit

Fondi i Kompensimit është skemë mbrojtëse në sigurime, nëpërmjet të cilës dëmshpërblehen të dëmtuarit nga aksidentet e shkaktuara nga mjete të pasiguruara ose të paidentifikuara. Ndryshimet e bëra përmes Ligjit nr. 32/2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” përcaktojnë krijimin e një fondi garancie me vlerë minimale prej 150 milionë lekë, si dhe mbajtjen e provigjoneve nga ana e shoqërive të sigurimit, për dëmet, objekt i Fondit të Kompensimit, në proces gjyqësor apo në proces trajtimi, si edhe të drejtën e shoqërisë së sigurimit (si sigures i drejtpërdrejtë) të kryejë funksionet e entit kompensues për trajtimin dhe pagesën e dëmeve. Trajtimi i dëmeve nëpërmjet siguresit të drejtpërdrejtë ka sjellë një reduktim të ngarkesës në procesimin e rasteve nga Byroja Shqiptare e Sigurimit.

Reduktimi i numrit të dëmeve të mbartura prej vitesh, ristruktimi i Byrosë Shqiptare të Sigurimit, ulja e numrit të thirrjeve të garancive për Kartonin Jeshil, sollën gjithashtu daljen e Byrosë nga monitorimi thuajse 10-vjeçar i Këshillit të Byrove.

Autoriteti do të monitorojë në vijimësi Byronë Shqiptare të Sigurimit dhe shoqëritë e sigurimit për respektimin e kërkesave ligjore e rregullatore në lidhje me Fondin e Kompensimit. Nëpërmjet monitorimit rigoroz të procedurave për pagesat e dëmeve, Autoriteti do të synojë eliminimin e problematikave për praktikën e dëmeve Fond Kompensimi, me synim uljen e nivelit të detyrimeve të Fondit të Kompensimit, kryesisht për dëmet me datë aksidenti të hershme.

Skema e kompensimit të investitorëve në tregun e kapitaleve është një mekanizëm mbrojtës që synon të mbrojë investitorët kundrejt riskut të humbjeve në rastin e paaftësisë së shoqërisë komisionere për të paguar detyrimet në para apo instrumente financiare, të mbajtura në emër të klientit dhe të administruara prej saj. Kjo skemë gjen aktualisht zbatim në vendet e Bashkimit Evropian, si një kërkesë e legjislacionit evropian.

Ligji për tregjet e kapitalit hedh bazat për krijimin e kësaj skeme, për funksionimin e së cilës duhet të hartohen rregulla të mëtejshme. Mbështetur në Ligjin nr. 62/2020 “Për tregjet e kapitalit”, kërkohet krijimi i skemës së kompensimit brenda një periudhe 5-vjeçare nga miratimi i ligjit. Për këtë arsye, synohet që brenda afatave të parashikuara në ligj të përcaktohen rregullat për krijimin dhe funksionimin e skemës së kompensimit të investitorëve, si edhe të bëhet një studim tregu për të vlerësuar mundësinë e funksionimit të skemës mbrojtëse për investitorët.

3.2 Rritja e përfshirjes financiare në tregjet nën mbikëqyrje

Përfshirja financiare synon që individët dhe bizneset të kenë qasje në produkte dhe shërbime financiare të dobishme dhe të përbalueshme, që plotësojnë nevojat e tyre dhe ofrohen në mënyrë të përgjegjshme dhe të qëndrueshme, si: transaksione, pagesa, kursime, investime dhe sigurime. Falë qasjes më të madhe në shërbimet financiare, individët mund të menaxhojnë më mirë nevojat e tyre të përditshme, të kapërcejnë më lehtë ngjarjet e papritura dhe të angazhohen në planifikim afatgjatë, përmes kursimeve dhe investimeve.

Rritja e përfshirjes financiare të individëve dhe bizneseve, mund të mbështetet përmes avancimit me sigurimet gjithëpërfshirëse, krijimit të produkteve të reja që i përshtaten nevojave të konsumatorit dhe investitorit, lehtësimit të aksesit ***në shërbimet e investimeve nëpërmjet digjitalizimit, përfshirjes automatike*** të të punësuarve, në skemat e fondeve private të pensionit, etj. Rritja e aksesit dhe mbulimi me sigurim i kategorive me të ardhura të ulëta dhe të mesme, është thelbësore për rritjen e përfshirjes financiare në sigurime (*inclusive insurance*).

Ligji nr. 62/2020 “Për Tregjet e Kapitalit” ka krijuar dimensione të reja për ndërlidhjen me tregjet globale, të favorizuar nga zhvillimet teknologjike në industrinë e shërbimeve financiare. Digjitalizimi i mëtejshëm i shërbimeve të investimit do të sjellë jo vetëm diversifikim ***të mundësive për investitorët vendas dhe zgjerim të mëtejshëm të tregut, por gjithashtu do të rrisë*** aksesin ***në shërbimet financiare, nëpërmjet përfshirjes së drejtpërdrejtë në instrumenta të listuara dhe tregtuara në tregjet e njohura ndërkombëtare.***

Përfshirja automatike e punëmarrësve në skemat private të pensionit, e parashikuar në ligjin e ri për fondet private të pensionit, i cili pritet të miratohet nga Kuvendi, pritet të ndikojë në zgjerimin e mëtejshëm të tregut, si dhe në rritjen e aksesit ***në skemat private të pensionit, për të zgjeruar dhe rritur në të ardhmen mbrojtjen sociale për këto kategori individësh.***

3.3 Rritja e edukimit financiar dhe trajnimi i profesionistëve

Zhvillimet dinamike në tregjet financiare jobankare shoqërohen me nevojën e vazhdueshme për informimin dhe edukimin e publikut. Përfshirja e teknologjive të reja në shërbimet financiare (FinTech), sidomos në tregun e kapitaleve, e vendosin publikun përballë informacioneve jo lehtësisht të kuptueshme.

Autoriteti do të synojë të lehtësojë një qasje më të gjerë të publikut në produktet financiare me qëllim zbutjen e rrezeve dhe rritjen e besimit në institucionet financiare në vend.

Ndërmarrja e iniciativave konkrete dhe planeve të veprimit do të detajohet përmes miratimit nga Autoriteti të një strategjie të posaçme për edukimin dhe përfshirjen financiare, në përputhje me dinamikat e tregjeve nën mbikëqyrje. Iniciativat edukuese dhe informuese në kuadër të Strategjisë, do të koordinohen edhe me institucione të tjera si Banka e Shqipërisë, Ministria e Arsimit, si dhe me shoqatat e profesionistëve që veprojnë në tregjet financiare.

Ndryshimet klimatike janë një sfidë e përbashkët, me ndikim edhe në sistemin financiar dhe rrjedhimisht kërkohet ndërveprim dhe iniciativa jo vetëm në nivel kombëtar, por edhe global. Autoriteti, do të ndërmarrë një sërë nismash që synojnë rritjen e ndërgjegjësimit për efektet financiare dhe ekonomike të ndryshimeve klimatike dhe risqet që lidhen me to, për t'i bërë faktorët mjedisorë pjesë integrale të politikave financiare dhe për të ndryshuar sjelljen financiare të investitorit shqiptar drejt përfshirjes së produkteve të gjelbra në portofolin e tij të investimeve.

Autoriteti synon promovimin e rolit të sektorit financiar për një ekonomi të qëndrueshme dhe identifikimin e kushteve bazë për krijimin e një ekosistemi, që nxit financa të qëndrueshme dhe të gjelbra, sikurse mund të jetë një kuadër i përshtatshëm rregullator, infrastrukturë e përshtatshme tregu, apo kërkesa për raportim dhe transparencë.

Autoriteti ka rishikuar bazën rregullatore dhe ka zhvilluar programe edukuese me synim rritjen e njohurive të grupeve të profesionistëve që veprojnë në tregjet financiare jobankare. Programet edukuese lidhen si me trajnimet për formim profesional për ekspertët që licencohen për herë të parë në tregjet nën mbikëqyrjen e Autoritetit, ashtu edhe me edukimin në vazhdim të ekspertëve të licencuar dhe që veprojnë në tregjet nën mbikëqyrje.

Autoriteti do të vijojë të ketë si objektivi kryesor edukimin dhe trajnimin në vazhdimësi të profesionistëve të tregjeve nën mbikëqyrje. Ky objektivi lidhet edhe me dinamikën e shpejtë të zhvillimit të tregjeve me përfshirjen e FinTech në botën financiare. Duke iu përgjigjur zhvillimeve në fushën e tregut të kapitaleve, përparimit teknologjik në fushën e shërbimeve financiare të bazuara në regjistrat e shpërndarë, Autoriteti do të bashkëpunojë me shoqatat e profesionistëve të këtyre tregjeve për të krijuar module trajnimi për profesionistët në bazë të kërkesës dhe nevojave.

Të gjitha objektivat dhe iniciativat e mësipërme, në edukimin e profesionistëve, do t'i shërbejnë rritjes së rolit të Autoritetit në formimin e profesionistëve të kualifikuar dhe për rrjedhojë rritjen e cilësisë së shërbimit dhe mbrojtje më të mirë për konsumatorët dhe investitorët.

PRIORITETET NDËRSEKTORIALE

4. FINANCIMI I GJELBËR

Zhvillimi i financimit të gjelbër dhe harmonizimi me praktikat evropiane në financat e gjelbra vlerësohen thelbësore për një ekonomi dhe sistem financiar të qëndrueshëm. Sektori financiar ka rol kyç në këtë drejtim, për të riorientuar investimet drejt teknologjive dhe bizneseve të gjelbra, si edhe për të financuar rritjen në një mënyrë të qëndrueshme dhe afatgjatë. Mobilizimi i flukseve financiare dhe i investimeve në projekte të gjelbra është me rëndësi, pasi i shërben arritjes së objektivave klimatike dhe mjedisore në kuadër të nismës *European Green Deal*, angazhimeve të ndërmarra nga Shqipëria sipas marrëveshjes së Parisit, si dhe agjendës 2030 të Kombeve të Bashkuara për një zhvillim të qëndrueshëm.

Për arritjen e këtyre objektivave kërkohet bashkërendimi i përpjekjeve dhe koordinimi me të gjithë aktorët, me qëllim ndërmarrjen e një sërë veprimesh:

- Krijimi i një sistemi të unifikuar klasifikimi në linjë me praktikat evropiane përmes vendosjes së rregullave për taksonominë, i cili do të përcaktojë kriteret kur aktivitetet ekonomike apo investimet do të konsiderohen të gjelbra dhe qëndrueshme nga ana mjedisore;
- Nxitja dhe promovimi i emetimit të obligacioneve të gjelbra, ku fondet nga emetimi i obligacioneve të alokohen në projekte me ndikim pozitiv tek klima apo mjedisi;
- Përfshirja në bazën ligjore e rregullatore të kërkesave për transparencë dhe informacion lidhur me faktorët ESG (faktorë mjedisore, socialë dhe të qeverisjes korporative) dhe menaxhimi i rrezikut që lidhen me faktorët ESG;
- Promovimi i standardeve dhe parimeve globale për raportim të subjekteve që veprojnë në sektorin financiar, lidhur me përfshirjen e faktorëve ESG në aktivitetin e tyre;
- Edukim financiar për rritjen e ndërgjegjësimit lidhur me efektet financiare dhe ekonomike të ndryshimeve klimatike, me qëllim ndryshimin e sjelljes financiare të investitorit shqiptar, për të konsideruar faktorë mjedisore gjatë krijimit të portofolit të tij të investimeve.

4.1 Integrimi i parimeve të qëndrueshmërisë dhe përfshirja e faktorëve ESG në bazën rregullatore

Aktualisht, në nivel global po punohet për unifikimin e përkufizimeve të aktiviteteve që konsiderohen “green”, si dhe standardizimin e vlerësimit të faktorëve ESG (*ESG rating*), gjë që mbështet zhvillimin e tregjeve financiare të gjelbra drejt investimeve afatgjata të qëndrueshme. Standardizimi në nivel global i klasifikimit të produkteve financiare si produkte ESG nxit krahasueshmërinë e tyre dhe rrit besueshmërinë e investitorit, për të marrë vendimet e duhura, në përputhje me objektivat e tij lidhur me qëndrueshmërinë dhe faktorët ESG. Këto çështje po adresohen përmes organizatave ndërkombëtare si IOSCO, për të aprovuar sa më parë, fillimisht mbi baza vullnetare, standarde të unifikuara për raportim lidhur me faktorët ESG, të njohura si Standardet Ndërkombëtare të Qëndrueshmërisë.

Autoriteti synon promovimin dhe zbatimin e parimeve ESG në praktikat e emetuesve dhe pjesëmarrësve të tregut. Edhe në tregun e sipërmarrjeve të investimeve kolektive, përmes parashikimeve të Ligjit 56/2020 “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive”, është krijuar mundësia për njohjen e SIK, të cilat janë sipërmarrje të qëndrueshme që marrin në konsideratë faktorët ESG.

Sfidë e punës së Autoritetit është integrimi i faktorëve ESG për investime të qëndrueshme, rritja e ndërgjegjësisimit të investitorit shqiptar për të orientuar vendimmarrjen e tij drejt produkteve financiare të gjelbra.

Rritja e kërkesave për transparencë dhe informacion lidhur me faktorët ESG dhe menaxhimi i rrezikut të këtyre faktorëve përbën domosdoshmëri, në mënyrë që investitori të marrë vendime të mirëinformuara lidhur me produktet financiare.

Në linjë me ndryshimet e ndërmarra në kuadrin rregullator të BE- së, Autoriteti synon krijimin e rregullave për transparencë, në mënyrë që shoqëritë komisionere/bankat, gjatë vlerësimit të përshtatshmërisë së klientit për një produkt, apo shërbim financiar të marrin në konsideratë edhe faktorët ESG dhe preferencat e klientit lidhur me këta faktorë.

Autoriteti gjithashtu do të shikojë mundësinë për vendosjen e rregullave që parashikojnë detyrimin e investitorëve institucionalë dhe menaxherëve të aseteve për të bërë publike informacionin mbi integrimin e faktorëve ESG në aktivitetin e tyre, përfshirë analizën e riskut të këtyre faktorëve.

Autoriteti synon të vendosë kërkesa për hartimin e një *Benchmark-u* përfshirë edhe atë klimatik, që i shërben vlerësimit të instrumenteve financiare dhe performancës së fondeve të investimit, në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian.

Në projektligjin “Për fondet e pensionit privat”, Autoriteti ka parashikuar që në rast se faktorët ESG janë aplikuar në politikën e investimit të fondeve private të pensionit, shoqëritë administruese duhet t’i marrin në konsideratë këta faktorë gjatë procesit të vetëvlerësimit të rrezikut dhe të deklarohen në prospekt, si dhe në deklaratën mbi parimet e politikës së investimit për secilin fond.

Autoriteti do të monitorojë në mënyrë të kujdesshme zbatimin e këtyre parashikimeve ligjore në drejtim të rritjes së transparencës dhe ndërgjegjësisimit të anëtarëve të fondeve private të pensionit ndaj faktorëve ESG në përzgjedhjen e fondit ku ata duan të investojnë.

4.2 Promovimi i emetimit të Obligacioneve të Gjelbra

Nxitja dhe promovimi i emetimit të Obligacioneve të Gjelbra (*Green Bonds*) përbën një nga prioritetet e Autoritetit, në mënyrë që fondet e përfituara nga emetimi i obligacioneve të alokohen në projekte me ndikim pozitiv tek klima apo mjedisi. Një standard i unifikuar për obligacione të gjelbra inkurajon pjesëmarrësit e tregut të emetojnë dhe të investojnë në këto instrumenta financiarë, duke rritur efektivitetin dhe besueshmërinë në tregjet financiare.

Autoriteti, si pjesë e planit të veprimit të tij për financa të qëndrueshme, në linjë me praktikën evropiane (*EU Green Bond Standard*), synon vendosjen e një standardi për obligacionet e gjelbra. Gjatë emetimit të *obligacioneve të gjelbra*, emetuesit përfitojnë nga imazhi dhe tregtueshmëria e tyre, ndërsa investitorët nga produkte që i përgjigjen objektivave të tyre të investimit. Kështu, përfshirja e sektorit financiar në investime që lidhen me qëndrueshmërinë krijon njëkohësisht mundësi për instrumente të reja financiare, që aktualisht i mungojnë tregut shqiptar të kapitaleve. Ky treg paraqet potencial të madh për zhvillimin dhe zgjerimin e produkteve financiare të qëndrueshme.

Me qëllim zhvillimin e këtij tregu, Autoriteti do të bashkërendojë punën me institucione të tjera me rol kyç në tregun e kapitaleve, për të analizuar mundësinë e krijimit të standardeve për emetimin e obligacioneve të gjelbra.

4.3 Koordinim ndërinstitutional për nxitjen e financave të gjelbra

Suksesi i objektivit për riorientimin e kapitalit drejt investimeve të qëndrueshme dhe të gjelbra, kërkon bashkërendimin e përpjekjeve dhe angazhimin e të gjithë aktorëve, sektorit publik, atij privat, rregullatorëve dhe të gjithë palëve të interesit.

Autoriteti në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse do të përfshihet në: i) krijimin e një *roadmap* për financa të gjelbra; ii) vlerësimin e mundësive për emetimin e një obligacioni shtetëror të gjelbër (*sovereign green bonds*); iii) vendosjen e kriterëve për institucionet që synojnë të bëjnë vlerësim të produkteve financiare të gjelbra; dhe iv) krijimin e një taksonomie për aktivitetet e gjelbra, në linjë me praktikën dhe rregullat e BE-së për taksonominë.

Krijimi i një sistemi të unifikuar klasifikimi përmes vendosjes së rregullave për taksonominë, do të përmbajë kriteret që përcaktojnë se kur aktivitetet ekonomike apo investimet do të konsiderohen të gjelbra dhe qëndrueshme nga ana mjedisore, duke ofuar qartësi për të gjithë palët e interesuara.

5. DIGJITALIZIMI DHE SISTEMET E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT

Digjitalizimi dhe inovacioni financiar po evoluojnë me ritëm të shpejtë, duke ndikuar modelet e biznesit, produktet dhe shërbimet financiare, kanalet e shpërndarjes, por duke rritur edhe ekspozimin ndaj rrezikut kibernetik. Përmirësimi dhe modernizimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit sipas teknologjisë bashkëkohore dhe praktikave më të mira, mbështet Autoritetin në përmbushjen e misionit dhe realizimin e objektivave të tij. Eksperiencat e vendeve të tjera kanë dëshmuar se përdorimi i teknologjisë financiare ka rezultuar të jetë shumë i dobishëm për Autoritetet mbikëqyrëse, si në tregjet e sigurimeve, ashtu edhe në tregjet e kapitalit dhe фондеve.

Autoriteti do të shikojë mundësinë për implementimin e teknologjive të reja, me qëllim përmirësimin e proceseve mbikëqyrëse dhe rregullatore, zgjerimin e funksionaliteteve të sistemeve për gjenerimin e raporteve analitike, lehtësimin e përdorimit të shërbimeve për palët e interesuara, si dhe rritjen e sigurisë kibernetike.

Autoriteti, gjithashtu do të punojë për forcimin e kapaciteteve dhe do të rrisë bashkëpunimin me institucione të tjera ndërvepruese sipas fushave.

5.1 Përmirësimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit

Përmirësimi i sistemeve të brendshme dhe të sistemeve të raportimit për tregjet nën mbikëqyrje do të jenë prioritet për Autoritetin në periudhën 2023–2027. Në këtë drejtim, do të vijohet me përmirësimin dhe zhvillimin e sistemeve të raportimit për tregun e фондеve të investimeve dhe të pensioneve private vullnetare, për tregun e sigurimeve, krijimin e një ndërfaqje për regjistrin e shitjeve të produkteve të sigurimit të detyrueshëm motorrik, si dhe zhvillimin e mëtejshëm të Regjistrin Online të Shitjeve dhe të Sistemit të Dëmeve, sipas dinamikave të tregut.

Zhvillimet e sistemeve të teknologjisë së informacionit do të shërbejnë për digjitalizimin e proceseve të raportimit, standardizimin dhe automatizimin e proceseve mbikëqyrëse, qasje në kohë reale në sistemet e subjekteve të mbikëqyrura, analizimin dhe menaxhimin e të dhënave të tregjeve nën mbikëqyrje në mënyrë efektive, si dhe për të ruajtur integritetin e tregut.

Në kuadër të mbështetjes për zhvillimin dhe përdorimin e avancuar të teknologjive të reja në shërbimet financiare (FinTech), sfidë përbën mbrojtja e të dhënave, menaxhimi i riskut përmes agregimit të të dhënave, automatizimi i veprimeve sipas kërkesave rregullatore, menaxhimi dhe kontrolli i identitetit (KYC/AML), identifikimi dhe parandalimi i praktikave abuzuese, monitorimi i transaksioneve, raportimi rregullator etj. Në varësi të zhvillimeve të ardhshme në tregun financiar bazuar në teknologjitë e reja në vend, madhësisë së tregut dhe kompleksitetit të produkteve, do të identifikohen, shqyrtohen dhe prioritetizohen çështjet me impakt në ekosistemin e FinTech.

5.2 Rritja e sigurisë kibernetike

Zhvillimet e reja teknologjike kërkojnë fuqizim të mjeteve teknologjike dhe juridike, ngritje të kapaciteteve profesionale, si edhe rritje të bashkëpunimit me institucionet e tjera ndërvepruese vendase apo të huaja, me qëllim shmangien e risqeve dhe rritjen e sigurisë kibernetike.

Siguria ndaj sulmeve kibernetike çdo ditë e më shumë po bëhet më sfiduese për t'u menaxhuar. Kjo për faktin se sulmuesit kibernetikë ndryshojnë vazhdimisht metodat e ekzekutimit të sulmeve, të cilat janë të paparashikueshme. Sfidë për AMF-në është zhvillimi i sistemeve aktuale dhe përditësimi i tyre me teknologjitë më të përparuara për të parandaluar sulmet ndaj të dhënave, që përdoren nga palët e interesuara. Objektiv do të jetë gjithashtu përmirësimi i procedurave dhe politikave të sigurisë në sistemet që administrojnë Autoriteti.

